



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Z E D H E N E S I

Tiranë, më 02 /8/ 2014

Njoftim për Shtyp

KLSH KALLËZON NË PROKURORI ISH DREJTORIN DHE 9 ISH PËRGJEGJËSA
SEKTORI TË ALUIZNI ELBASAN

Kanë kryer legalizime të jashtëligjshme për 182 subjekte me diferencë në parcelat ndërtimore, brenda Studimin Urbanistik të Qendrës së qytetit Elbasan, në zonat e gjelbëruara pronë e bashkisë Elbasan, brenda brezit mbrojtës të hekurudhave, brenda ose pranë vijës së ndërtimit të strukturës së rrugës dhe kanaleve kullues, si dhe të pavetdeklaruara me një dëm ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit në vlerën 412 milionë lekë ose 4 milion dollarë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të auditimit 804/3, datë 11/11/2013, ka audituar Agjencinë Rajonale të Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) Elbasan, për periudhën Janar 2011- Shtator 2013.

Nga ky auditim, u konstatuan një sërë shkeljesh të dispozitave ligjore, për të cilat KLSH ka kryer kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për ish-drejtorin e këtij institucioni, L.H, dhe ish-përgjegjësit e sektorëve A.Z., B.V., V.H., M.H., I.D., H.P., F.L., E.T. dhe A. XH., për konsumim të elementëve të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, neni 248 i Kodit Penal, për:

1. Shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e procedurave ligjore në mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, në përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin e objektit informal (leje legalizimi), shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale, si dhe në përgatitjen dhe dërgimin e dokumentacionit për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale nga Shteti tek poseduesi i ndërtimit pa leje, në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, VKM nr. 438, datë 28.6.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”.

2. Lejim të parregullsive në plotësimin e dosjeve, duke legalizuar objekte në kundërshtim me ligjin në:

167 raste për sipërfaqen prej **47583.⁸³ m²**, në vlerë **412,442,529** lekë duke shkaktuar dëm ekonomik si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit, për fondin e kompensimit të ish pronarëve, si diferencë e pagesës së sipërfaqes së parcelës ndërtimore të papaguar, ndërmjet sipërfaqes së legalizuar (me leje legalizimi) dhe sipërfaqes së parcelës ndërtimore të zaptuar në fakt nga poseduesi, e cila duhet shitur me vlerën e tregut, në kundërshtim me nenet 17, 19 dhe 20. të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”;

5 raste janë jashtë kondicioneve urbane, pranë rrugëve dhe linjave të hekurudhave, në kundërshtim me nenin 2, të ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, pikën 2, të VKM nr. 438,

datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, si dhe pikën 66 dhe 127, të VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”;

5 dosje janë brenda Studimit Urbanistik të Qendrës së qytetit, Bashkia Elbasan, në kundërshtim me nenin 39, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe pikën 2, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006;

3 dosje janë në zonë të gjelbër me status juridik, pronë e Bashkisë Elbasan, sipas VKM nr. 416, datë 11.07.2007, në kundërshtim me nenin 31, pika 1, germa “a” dhe nenin 39, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe VKM nr. 438, datë 28.6.2006, pika 2, germa “e” dhe pika 4, germa “a” dhe “b”;

2 dosje janë legalizuar objekte informale të pa vetëdeklaruar nga poseduesi i tyre, veprime në kundërshtim me pika 2 e nenit 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, pika 11 germa “a”, të VKM nr. 437, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e procedurave për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, për ngritjen e bazës së të dhënave”, pika 7/b, të VKM nr. 438, datë 28.6.2006, pika 7/b, si dhe Urdhri nr. 46, datë 18.07.2006 “Manuali i procedurave mbi procesin e vetëdeklarimit” pika 3.8.

Për ish Drejtorin L.H. të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Elbasan dhe ish përgjegjësat e sektorëve A.Z., B.V., V.H., M.H., I.D., H.P., F.L., E.T. dhe A. XH., të cilët në mospërmbyllje të detyrës së tyre funksionale dhe në shkelje të dispozitave ligjore, kanë konsumuar elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, KLSH ka kryer kallëzim penal për shpërdorim detyre duke i përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan të gjitha provat dhe dokumentet përkatëse.

Gjithashtu, KLSH i ka kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, fillimin e procedurave administrative e ligjore për dhënien e masës disiplinore “Zgjidhje kontratës së punës” për ish drejtuesin e ALUIZNI Elbasan dhe 9 përgjegjës sektori.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT